



Prishtinë, 19 nëntor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1450_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Nenit 15, Nenit 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.1, Nenit 30, Nenit 32 paragrafin 2, nënparagrafi 2.1, Nenit 34 dhe Nenit 38 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 7 të Ligjit për Energjinë Termike (Ligji Nr. 05/L-052);
- Dispozitat e Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Nr.07/2017);
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të prodhimit të Energjisë termike (nga Biomasa) të dorëzuar në Rregullator me datë 26.02.2021 nga ndërmarrja Ngrohroja e Qytetit SH.A., adresa: Rezinë, Gjakovë, (Lokacioni Rezinë) Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 19 nëntor 2021, nxori këtë:

VENDIM

I. LËSHOHET LICENCA PËR PRODHIM TË ENERGIJË TERMIKE ndërmarrjes "Ngrohroja e Qytetit" SH.A, me numër licence ZRRE/Li_75/21, për periudhën tridhjetë (30) vjeçare, nga data 19.11.2021 deri me datë 18.11.2051.

II. Obligohet ndërmarrja të sjell në Rregullator çdo dokument të lëshuar nga institucione të ndryshme për Ngrohroja e Qytetit SH.A të cilët mund të kenë ndikim në validitetin dhe periudhën e vlefshmërisë së licencës së lëshuar, si dhe çdo dokument i cili mund të ndryshoj nga ai i sjellë gjatë aplikimit për marrje të licencës.

Arsyetim

- o Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 26.02.2021 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit për Prodhimit të energjisë Termike (nga biomasa), me kapacitet të instaluar si më poshtë:
- o Gjeneratori për prodhim të energjisë nga Biomasa, është ndërtuar sipas procedurës së Autorizimit dhe në përputhje me të gjitha kërkesat që kërkohen me legjislacionin në fuqi për tu ndërtuar një gjenerator nga burimet e ripërtërishme të energjisë, dhe brenda afateve të përcaktuara me Rregullin për Autorizim, ka Aplikuar për marrjen e Licencës për prodhim të energjisë termike nga biomasa.



- Për licencim të këtij aktiviteti, Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi duke dërguar në Rregullator dëshmitë/kërkesat dhe të dhënat tjera të përcaktuara në Aplikacionin për Licencim.
- Sipas Nenit 6 të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja Ngrohtorja e Qytetit SH.A. me datë 06.08.2021 ka njoftuar palët e interesit përmes gazetave, se ka dorëzuar një aplikacion në Rregullator për licencim të aktivitetit të prodhimit të energjisë termike dhe se aplikacioni është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë pasur të drejtë të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë për ndonjë parregullsi të tij brenda tetë (8) ditësh kalendarike, nga data kur njoftimi është publikuar në gazetë. Rregullatori nuk ka pranuar ndonjë kundërshtim nga palët e interesit, për këtë aplikacion.
- Rregullatori në përputhje me nenin 7 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.
- Bordi i Rregullatorit ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të sipërpërmendur dhe legjislacionit tjetër në fuqi. Kështu duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- Licenca e lëshuar me datë 04 Tetor 2006, (Nr. i Licencës ERO/Li_02/06), e modifikuar me 18.07.2012 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_02/12), e modifikuar më 13.04.2017 (Nr. i Licencës ZRRE/Li_02/17) është e pa vlefshme meqë i skaduar afati i licencës me 04.10.2021, ndërsa të gjitha dispozitat e asaj licence për prodhim të energjisë termike mbulohen me këtë licencë për ndërmarrjen Ngrohtorja e Qytetit SH.A, dhe kjo licencë do të vazhdojë të jetë e vlefshme deri me datë 18 nëntor 2051, në pajtim me pikën I. të dispozitivit të këtij vendimi.
- Licenca e lëshuar do të jetë e vlefshme për periudhën sipas pikës I të dispozitivit të këtij Vendimi, me mundësi vazhdimi, nëse i licencuari aplikon për vazhdim licence jo më vonë se gjashtë (6) muaj para skadimit të afatit të licencës në pajtim me Nenin 15 të Licencës së lëshuar nga Rregullatori dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

I. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

II. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.



**bashkëngjitur licenca*

Vendimi i dërgohet:

- Ndërmarrjes Ngrohtorja e Qytetit SH.A
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Buçaj, anëtar